



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike në Kosovë
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publik dhe Informim
Subjekti: Mbatja e Kuvendit të Parë Zgjedhor të Forumit Rinor të AKR-së në Fushë-Kosovë

Pristhinë, 08 shkurt 2007

Kuvendi i Forumit Rinor të AKR-së, Dega në Fushë Kosovë, datë 07.02.2007

Dega e Forumit Rinor të Aleancës Kosova e Re në Fushë Kosovë mbajti më 7 shkurt 2007 Kuvendin e saj të Parë Zgjedhor. Në këtë Kuvend të pranishëm ishin 52 delegatë, të cilët për Kryetare zgjodhën Shehrije Kelmendin, koordinatorën e deritashme të Forumit Rinor në Fushë Kosovë. Delegatët e pranishëm për nënkryetar zgjodhën Faton Spahiun, sekretar Valon Xhigolin si dhe 9 anëtarë tjerë të Kryesisë.

Punimet e këtij Kuvendi i përshëndetën Kryetari i Degës së AKR-së në Fushë Kosovë Muharrem Zogijani, ndërsa në emër Këshillit Iniciues Qëndror të Forumit Rinor një fjalë rasti e mbajti Koordinatorin e këtij forumi Kreshnik Sylejmani.